



ELITE ACRYLIC PAINT



PAKETIMI

3L / 9L / 15L



KOHA E THARJES

2-3 Ore



KONSUMI

11-14 m²/l

PËRSHKRIMI

ELITE ACRYLIC është një bojë e bardhë e përgatitur nga një emulsion i tipit "polimer në ujë" e destinuar për lysterjen e fasadave të jashtme, që përveç rezinave akrilike dhe ujit përmban në përqindje të caktuara mbushës, pigmente e shtesa të tjera sikurse janë dioksid titani, karbonat kalciumi, heksametafosfat natriumi, hidroksietilcelulozë, izotiazolinon, poliksiloksane, poliakrilat natriumi hidroksid kaliumi, të cilët përmirësojnë vetitë e bojës. Referuar përbërësve të saj, boja thahet 3 - 4 orë pas aplikimit, duke formuar një mbulesë të rrafshët fleksibël, e cila ka rezistencë shumë të mirë ndaj fërkimit dhe qëndrueshmëri shumë të mirë ndaj kushteve klimaterike.

FUSHA E PËRDORIMIT

ELITE ACRYLIC është e përdorshme në fasadat e jashtme, për bojatisjen e sipërfaqeve të suvatuara ose sipërfaqeve prej betoni.

PARAPËRGATITJA

Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra). Paraprakisht zmerilohet sipërfaqja me letër zmerile nr 36 dhe 50. Në sipërfaqet e reja duhet të kalohet paraprakisht një dorë astari tretësi NEON DUR i cili hollon me WHITE SPIRIT ose astari akrilik AN – 501 që hollon me ujë në raportin 30%.

PËRDORIMI

Përgatitet boja duke i shtuar ujë deri në konsistencën e kërkuar. Për të realizuar një lysterje të mirë, duhet të aplikohen dy duar ELITE ACRYLIC . Për dorën e parë hollimi i bojës me ujë duhet të jetë në masën 15-20%. Ndërsa për dorën e dytë e cila aplikohet pasi të jetë tharë plotësisht dora e parë, hollimi me ujë bëhet deri deri në masën 10%. Doza e pigmentit që mund të përdoret, është sipas rekomandimit të prodhuesit. Lysterja aplikohet lehtësisht me rrul ose furçë.

KUJDES

Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 50C. Pas përfundimit të lysterjes pajisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.



SKEDA TEKNIKE

Aparenca	Emulsion uxor i bardhë
Densiteti (ISO2811, DIN 53217, ASTM D 1475)	1.5-1.55 g/cm ³
Viskoziteti (RVDV -2T,R7)	4500-6500 cp
Mbetja e thate (Thermostat, 105°C/2orë)	≤ 64 %
Forca ndermolekulare (RVDV -2T,R7)	80000-120000 newton/m ²
Viskoziteti kinematik (RVDV -2T,R7)	2800-4000 mm ² /s
pH	≥8
Imtësia e grimcës (Elcometer 2050, ISO 1524; ASTM D 1210)	10-30 μm